



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës më, 14.07.2026

TERMAT E REFERENCES

Përkufizime

Referuar ligjit nr. 52/2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe të Risigurimit”, rregullores për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, VKM nr. 382 date 13.05.2020 Për “Sigurimin e Jetës së Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”

- 1. “Kushtet standarde të kontratës së sigurimit”** janë pjesë e kushteve të kontratës së sigurimit, të cilat shërbejnë si kushte minimale të detyrueshme për tu zbatuar nga shoqëritë e sigurimit.
- 2. “I Siguruari”** do të quhet individ(ët) e emërtuar si të siguruar në listën e “Grupit të siguruarve” ose në ndryshime të mëvonshme të saj.
- 3. “Grup i Siguar”** është grupi i punonjësve që kryejnë funksione operacionale në veprimtarinë e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi dhe që kanë të drejtë të sigurohen me këtë kontratë.
- 4. “Siguruesi”** është shoqëria e sigurimit jetë/vojë të licencuar nga Autoriteti për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat në të cilën përshihet ky produkt.
- 5. “Kontraktuesi”** është punëdhënësi i përcaktuar si Kontraktues në Formularin e Policës.
- 6. “Polica e sigurimit”** është dokumenti që provon lidhjen e kontratës së sigurimit, formulari dhe çdo shtojcë ose ndryshim i mëvonshëm i lëshuar nga Siguruesi.
- 7. “Çertifikatë e Sigurimit”** është dëshmia e sigurimit që “Siguruesi” i lëshon të “Siguarit
- 8. “Prim i sigurimit”** është shuma e mjeteve monetare që kontraktuesi i paguan Siguruesit për lidhjen e kësaj kontrate.
- 9. “Limiti i përgjegjësisë”** është shuma e sigurimit e përcaktuar në policën e sigurimit e cila nuk mund të jetë më e ulët se 10.000.000 (dhjetë milion) lekë.

10. “Përfitim” është shuma përkatëse e sigurimit ose pjesë e saj siç përcaktohet në policën e sigurimit dhe tabelën e përfitimeve, e pagueshme nga siguruesi në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj police, për cdo ngjarje ose dëmtim që mbulohet nga kjo policë.

11. “Aksident” është ngjarja që ndodh gjatë kryerjes së shërbimit operacional ose për shkak të tij, sipas kushteve dhe periudhës së mbulimit të përcaktuar në kontratën e sigurimi

Objekti

Me anë të kësaj Kontrate Sigurimi, siguruesi dhe i siguruari bien dakort që kundrejt pagimit të primit të sigurimit në favor të siguruesit, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (nëse ka) të kësaj kontrate, siguruesi do të dëmshperblejë të siguruanin në mënyrën dhe masën e parshikuar në këtë kontratë nëse ndodh dhe vërtetohet rasti i sigurimit.

Mbulimi në sigurim

1. Kontrata e sigurimit të jetës nga aksidentet të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin mbulon ngjarjet aksidentale gjatë kryerjes së shërbimit operacional ose për shkak të tij, si më poshtë vijon:

- a) Vdekja si rezultat i aksidentit;
- b) Paaftësi e përhershme gjatë shërbimit ose aftësi e kufizuar gjatë shërbimit, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti gjatë shërbimit ose për shkak të saj;
- c) Paaftësi e përhershme gjatë shërbimit ose aftësi e kufizuar gjatë shërbimit, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundje;
- d) Paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;
- e) Paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundje;
- f) Shërbimet spitalore dhe/ose mjekësore në spitalet publike ose bazuar në marrëveshjen me shtetet e tjera për mbulimet shëndetësore që nuk ofohen në spitalet publike të vendit.

E drejta për të qenë i siguruar

Kanë të drejtë të sigurohen personat, anëtarë të “Grupit të Sigurimit”.

Hyrja në fuqi e kontratës së sigurimit

Kontrata e Sigurimit hyn në fuqi në orën 24:00 të ditës së përcaktuar në këtë kontratë.

Primi i sigurimit

1. Tarifa e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 0.5 për qind e shumës së siguruar të përcaktuar në formularin e Policës së sigurimit.

2. Primi i sigurimit paguhet sipas përcaktimeve në formularin e Policës së sigurimit.

Shuma e sigurimit

Shuma e sigurimit për çdo punonjës të siguruar, e përcaktuar në formularin e Policës së sigurimit, nuk mund të jetë më e ulët se 10 000 000 (dhjetë milion) lekë.

Grafiku i përfitimeve

1. Grafiku i përfitimit klasifikohet nga i siguruari, duke përcaktuar shumat e sigurimit për çdonjërin prej tyre. Grafiku i përfitimeve mund të jetë i thjeshtë ose i përbërë.

2. Forma dhe lloji i grafikut vendosen sipas kërkesës së kontraktuesit dhe me marreveshje midis palëve, por në asnjë rast shuma e zgjedhur e sigurimit, s'mund të jetë më e ulët se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Tabela e Përfitimeve

Përfitimi i pagueshëm në përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në formular

			Vlera ne lek
A	Humbja e jetës	100%	10.000.000
B	Paaftësi e Përhershme		
1	Paaftësi e Plotë e Përhershme	100%	10.000.000
2	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të dy gjymtyrëve	100%	10.000.000
6	Humbje e plotë e përhershme e shikimit në të dy sytë	100%	10.000.000
7	Humbje e plotë e përhershme e shikimit në një sy	50%	5.000.000
8	Humbje ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe humbja e shikimit në një sy	100%	10.000.000

9	Humbje e të folurës dhe dëgjimit	100%	10.000.000
10	Humbje e plotë e përhershme e dëgjimit		
a)	në të dy veshët	60%	6.000.000
b)	në një vesh	30%	3.000.000
11	Humbje e plotë e të folurës	30%	3.000.000
12	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës		
a)	të djathtë	42%	4.200.000
b)	të majtë	40%	4.000.000
13	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të dorës		
a)	gishti i madh i dorës së djathtë	20%	2.000.000
b)	gishti i madh i dorës së majtë	15%	1.500.000
c)	gishti tregues, apo i mesit i dorës së djathtë	12%	1.200.000
d)	gishti tregues, apo i mesit i dorës së majtë	10%	1.000.000
e)	gishti i parafundit, ose gishti i vogël i dorës së djathtë	4%	400.000
f)	gishti i parafundit, ose gishti i vogël i dorës së majtë	3%	300.000
14	Humbje ose humbje e plotë e falangës së gishtit të dorës	1/3 e gishtit përkatës	
15	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës		
a)	të gjithë gishtërinjtë e një këmbe	20%	2.000.000
b)	gishti i madh i këmbës	10%	1.000.000
c)	një gisht i këmbës (II-V)	2,5%	250.000
16	Imobilitet i plotë i përdorimit të një këmbe në nivelin e nyjes së këmbës	30%	3.000.000
17	Imobilitet i plotë i kofshës në nivelin e artikulationit koksofemoral	40%	4.000.000
18	Imobilitet i plotë i artikulationit të kycit	30%	3.000.000

19	Dëmtimi i plotë një veshke	40%	4.000.000
20	Dëmtimi i plotë i shpretkës	20%	2.000.000
21	Djegje të shkallës së tretë 3.500.000	35%	

Zona	Dëmtimi si përqindje e Sipërfaqes së Përgjithshme të Trupit		
- koka	e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	20%	2.000.000
	e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	35%	3.500.000
	e barabartë ose më e madhe se 8%	75%	7.500.000
- trupi	e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	20%	2.000.000
	e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	35%	3.500.000
	e barabartë ose më e madhe se 20%	75%	7.500.000

Përfitimi i pagueshëm **ditor**

si përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar
në Formular

C: Paaftësia e përkohshme

1 Paaftësia e përkohshme e plotë	0,025%, por jo më shumë se 4,000 lekë
2 Paaftësia e përkohshme e pjesshme	0,010%, por jo më shumë se 2,000 lekë

Përjashtimet

Për efekte të kësaj kontrate sigurimi nuk do të mbulohet rasti i sigurimit shkaktuar në kushtet e:

1. Luftës, pushtimit, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes dhe akte terroriste, përveç rasteve kur është gjatë kryerjes së shërbimit operacional ose për shkak të tij;

2. Veprimet të armëve të shkatërrimit në masë si armët bërthamore dhe bakteriologjike, kontaminimit radioaktiv, shpërthimeve bërthamore, përveç rasteve kur është gjatë kryerjes së shërbimit operacional ose për shkak të tij;
3. Përmbajtjeve, zhvendosjes së tokës, tërmetejeve, shpërthimeve vullkanike përveç rasteve kur është gjatë kryerjes së shërbimit operacional ose për shkak të tij;
4. Drejtimit të mjeteve motorrike tokësore, ujore, ajrore, pa qenë i pajisur me dëshminë përkatëse të aftësise, pjesmarrja në ngjitje alpinistike, gjatë fluturimit me avion të çdo lloji (përveç kur udhëton vetëm si pasagjer); gjatë ushtrimit të sporteve dimërore, garave me kuaj, makina dhe motoçikleta, etj;
5. Përdorimit të lëndëve eksplozive dhe korodive, përveç rasteve kur është gjatë kryerjes së shërbimit operacional ose për shkak të tij;
6. Përfshirjes së të siguarit në aktivitete të paligjshme, apo kriminale;
7. Dehjes, përdorimit të tepruar të psikofarmaceutikëve, drogës ose aluçinanteve;
8. Vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje ose akteve të kryera me dashje apo të tentuara nga I Siguruari / dhe ose përfituesi;
9. Sindromës së Deficiencës Imunitare të Fituar (AIDS) dhe gjendjeve shëndetësore të lidhura me të;

Njoftimet dhe deklaratimet

1. Kontraktuesi duhet ti dorëzojë Siguruesit, listën me identitetin e të gjithë pjesëmarrësve të grupit, moshën, çertifikatat individuale të sigurimit, policat e sigurimit personale për çdo individ, si dhe çdo informacion tjetër me shkrim që do të përcaktojë nivelin e përfitimit dhe të primit të sigurimit në këtë kontratë sigurimi dhe që janë pjesë përbërëse të saj.

2. Këto të dhëna i dorëzohen Siguruesit në:

- ☐ datën e fillimit të policës,
- ☐ çdo datë të rinovimit të policës,
- ☐ çastin kur çdo pjesëmarrës i përfshirë në grupin e siguar, bëhet i sigurueshëm për një shumë më të madhe sigurimi.

1. Siguruesi rezervon të drejtën t'i kërkojë këto të dhëna të tjera të siguruarit dhe/ose kontraktuesit, apo ti verifikojë ato në çdo datë kur sipas opinonit të Siguruesit është bërë një ndryshim i rëndësishëm në totalin e shumës së sigurimit në këtë policë.

Deklarimet e pasakta

1. Në rast se i Siguruari a kontraktuesi me dashje apo nga pakujdesia ka bërë deklarime të pasakta ose ka lënë në heshtje fakte apo rrethana të tilla për të cilat Siguruesi nuk do të lidhte kontratën e sigurimit, ky i fundit ka të drejtë:

- a) Të kundërshtojë vlefshmërinë e kontratës së sigurimit brenda 1 muaji nga dita që ka marrë dijeni për mosaktet e deklarimeve ose lënien në heshtje të tyre duke kërkuar ndryshimin e kushteve të saj;
- b) Të zgjidhë kontratën e sigurimit në rast se ka rrethana të tilla që po ti dinte Siguruesi nuk do të kishte lidhur kontratën;
- c) Të refuzojë në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit dhe në çdo kohë tjetër pagesën e përfitimeve.

2. Kontrata e sigurimit mbetet e vlefshme për ata të siguruar të cilëve nuk u referohen deklarimet e pasakta apo heshtja.

3. Primet e sigurimit të paguara deri në kohën që kërkohet zgjidhja e kontratës së sigurimit nuk i kthehen të Siguarit dhe/ose kontraktuesit.

4. Pas kalimit të 6 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së sigurimit ose e rinovimit të saj, kjo kontratë nuk mund të kundërshtohet më për deklarimet e pasakta, ose lënien në heshtje të fakteve nga kontraktuesi ose i Siguruari, përveç rastit kur vërtetohet se deklarimi i pasaktë është bërë me dashje dhe për efekt përfitimi.

Përfundimi i mbulimit në sigurim

1. Mbulimi në sigurim përfundon:

- a) Kur zgjidhet kontrata e punës midis të Siguarit dhe kontraktuesit. Në kontratën e **“Sigurimit në grup”**, kur i siguruari ka paguar pjesërisht primin e sigurimit, zgjidhja e kontratës së punës, bën që sigurimi të mbetet në fuqi deri në mbarim të periudhës së sigurimit, për vlerën e reduktuar të shumës së sigurimit në përpjestim me pagesën e primit të bërë nga i Siguruari;

- b) Në mënyrë të njëanshme, kur njëra nga palët nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate sigurimi:
 - kur përgjegjësia bie mbi Siguruesin, i Siguruari ose Kontraktuesi kanë të drejtën për pjesën e primit të sigurimit të paguar.
 - kur përgjegjësia bie mbi të siguruarin/kontraktuesin, Siguruesi ka të drejtën të mos u kthejë shumën e primeve të sigurimit të paguara.
- c) Kur Siguruesi konstaton rrethana të tilla, të cilat po të ishin të njohura në momentin e kërkesës për sigurim, do të përbënin shkak për moslëshimin e policës së sigurimit;
- d) Kur nuk është paguar primi i sigurimit;
- e) Kur i Siguruari arrin moshën kufi të daljes në pension;
- f) Kur është ekzekutuar plotësisht grafiku i përfitimeve ose ka mbaruar periudha e sigurimit.

Ndodhja e rastit të sigurimit

1. Me ndodhjen e rastit të Sigurimit, i Siguruari apo Përfituesi detyrohen të njoftojnë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e tij, si dhe të zbatojnë porositë e dhëna nga Siguruesi.

2. Një njoftim i tillë do të quhet i dhënë Siguruesit menjëherë nëse është bërë me shkrim brenda 5 ditëve nga ndodhja e Rastit të Sigurimit dhe në çdo rast.

3. Për të gjitha pagesat e përfitimit që do të bëjë Siguruesi duhet të dorëzohen paraprakisht këto dokumenta:

- a) çertifikata e lindjes së të Siguruarit;
- b) kërkesa për përfitim sëbashku me çertifikatën e Sigurimit dhe/ose policën e sigurimit;
- c) çdo dokument të kërkuar nga Siguruesi i cili vërteton detyrimin e tij për të paguar.

4. Dokumentacioni i plotë i dorëzohet Siguruesit. Shpenzimet për grumbullimin dhe dërgimin e dokumentacionit janë në ngarkim të të Siguruarit a Përfituesit.

5. Siguruesi duhet të paguajë dëmshpërblimin që rrjedh nga kjo kontratë sigurimi brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së dokumentave të nevojshme dhe që konsiderohen të plota. Çdo pagesë bëhet në monedhën e treguar në kontratën e Sigurimit, pranë zyrave të Siguruesit.

Lëshimi i dublikatës

Në rast se polica origjinale e sigurimit priset, griset ose bëhet e palexueshme, Kontraktuesi ose i Siguruari duhet të pajiset me një policë sigurimi tjetër me shpenzimet e tyre, në të cilën përmbahet shënimi “Dublikatë”.

Taksat dhe tatimet

Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit janë në ngarkim të Kontraktuesit dhe/ose të Përfituesve.

Juridiksioni

1. Përfitimet e sigurimit janë të kërkuara brenda 2 viteve nga data e lindjes të së drejtës për kërkimin e tyre.

2. Mosmarreveshjet që mund të lindin, në rast se nuk zgjidhen në mirëkuptim, do të zgjidhen nga gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

3. Përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në dispozitat e Kontratës së sigurimit do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Objekti: “ Shpenzime për sigurim jetës së punonjësve zjarrfikës”

Në zbatim të VKM nr. 382 datë 13.05.2020 për Sigurimin e Jetës së Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi nga aksidentet gjatë kryerjes së shërbimit ose për shkak të tij.

Afatet e ekzekutimit: Afati i sigurimit për një periudhë 1 (një) vjecare duke filluar nga data e lidhjes se kontrates

Grupi I Specifikimeve Teknike